

**URDHËR**  
**Nr. 4, datë 12.1.2011**

**PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E KRYERJES SË RIMBURSIMIT TË NJËSIVE  
TË QEVERISJES VENDORE TË PAGESËS PËR PAJISJET FISKALE DHE  
TAKSIMETRAT**

*(Ndryshuar me urdhrin nr. 4/1, datë 15.4.2011)*

*(i përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 15 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, Ministri i Financave

**URDHËRON:**

1. Njësitë e qeverisjes vendore, që sipas ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 1065, datë 29.12.2010 “Për kriteret dhe procedurat e kryerjes së rimbursimit nga taksa e biznesit të vogël, të pagesës për pajisjet fiskale dhe taksimetrat” të Këshillit të Ministrave, kanë bërë rimbursimin e subjekteve të biznesit të vogël, brenda datës 30 prill 2011, paraqesin pranë Ministrisë së Financave (sipas formatit bashkëlidhur këtij urdhri) kërkesën për vlerën që kërkohet për t’u rimbursuar deri në atë periudhë.

2. Kërkesa e njërive të qeverisjes vendore duhet të përmbajë:

a) Kërkesën me shkrim të firmosur nga nëpunësi i autorizuar i njësisë, me vlerën e fondit që kërkohet për t’u rimbursuar deri në atë periudhë.

b) Listën e subjekteve të biznesit të vogël që kanë përfituar rimbursim për pajisjen fiskale dhe taksimetrit (vlerën e saj, përfshirë edhe TVSH-në, por jo më shumë se vlera e përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1065, datë 29.12.2010) për ato subjekte që nuk janë të përfshirë në skemën e TVSH-së dhe që nuk regjistrohen në këtë skemë brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 10 354, datë 18.11.2010, të rakorduar me degën rajonale të tatim-taksave.

3. Rakordimi i njësive të qeverisjes vendore me degët rajonale të tatim-taksave të bëhet në përputhje me kërkesat e pikës 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1065, datë 29.12.2010 “Për kriteret dhe procedurat e kryerjes së rimbursimit nga taksa e biznesit të vogël të pagesës për pajisjet fiskale dhe taksimetrat.”.

4. Kërkesat për rimbursim dërgohen në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit pranë Ministrisë së Financave, e cila i administron këto kërkesa deri në përfundimin e procedurës për rimbursimin e njësive vendore, që kanë bërë kërkesë. Dokumentet origjinale do të arkivohen në protokollin e Ministrisë së Financave.

5. Me marrjen në dorëzim të këtij dokumentacioni, Ministria e Financave propozon projektvendimin pranë Këshillit të Ministrave, për rimbursimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël për njësitë e qeverisjes vendore, sipas vlerave përkatëse, nga zëri kontigjencë, parashikuar në buxhetin e vitit 2011. Ky fond, te njësitë e qeverisjes vendore do të kompensojë pjesën e taksës së biznesit të vogël, e cila ka rimbursuar pajisjen fiskale apo taksimetrit.

6. Pas miratimit nga Këshilli i Ministrave të vendimit për kompensim të njësive të qeverisjes vendore, Ministria e Financave (Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit), bëjnë alokimin e fondeve për rimbursim sipas njësive të qeverisjes vendore, te degët përkatëse të thesarit.

7. Transferimi i fondeve do të kryhet te llogaria buxhetore: Entiteti i Qeverisjes 001", Ministria 10, njësia shpenzuese 1010001, kapitulli 01, program 01130 (ekzekutimi i pagesave të ndryshme), artikulli 603.3 me emërtimin "Rimbursim për subjektet e biznesit të vogël për vlerën e pajisjeve fiskale", Kodi i Degës së Thesarit 3535.

8. Me hyrjen në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave për akordimin e fondeve për kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, që ka shkuar për rimbursimin e vlerës së pajisjeve fiskale, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit kryen çeljen sipas pikës 7.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit realizon në sistem kalimin e veprimit në qendër, sipas procedurës së transaksioneve me xhirim të brendshëm (pa lëvizje cash), në kategorinë "Xhirime brenda institucionit", vlerën përkatëse të çdo njësie të qeverisjes vendore në artikullin 7002100 (taksa e biznesit të vogël).

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE  
**Ridvan Bode**

Bashkia/komuna \_\_\_\_\_

Datë.....2011

| Nr. rendor | Emërtimi i subjektit | Vlera e plotë e pajisjes fiskale | Vlera e rimbursuar | Vlera e plotë e taksimetrit | Vlera e rimbursuar | Shuma që kërkohe për t'u kompensuar (lekë) |
|------------|----------------------|----------------------------------|--------------------|-----------------------------|--------------------|--------------------------------------------|
| 1          |                      |                                  |                    |                             |                    |                                            |
| 2          |                      |                                  |                    |                             |                    |                                            |
| 3          |                      |                                  |                    |                             |                    |                                            |
| 4          |                      |                                  |                    |                             |                    |                                            |
| 5          |                      |                                  |                    |                             |                    |                                            |
| 6          |                      |                                  |                    |                             |                    |                                            |
| 7          |                      |                                  |                    |                             |                    |                                            |
| 8          |                      |                                  |                    |                             |                    |                                            |
| 9          |                      |                                  |                    |                             |                    |                                            |
|            | <b>Totali</b>        |                                  |                    |                             |                    |                                            |

Drejtori/përgjegjësi i tatim-taksave

Dega rajonale e tatim-taksave

Kryetari i NJQV-së

Logoja e njësisë e qeverisjes vendore

Nr.....prot

Data.....2011

Për: Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit  
Ministria e Financave, Tiranë

Lënda: Kërkesë për rimbursim të vlerës së taksës së biznesit të vogël

Në bazë të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011” dhe urdhrin nr...., datë .....2011, të Ministrit të Financave, bashkia/komuna ..... kërkon rimbursimin e vlerës prej .....lekësh, të taksës së biznesit të vogël, me anë të së cilës ajo ka kompensuar bizneset për pajisjet fiskale dhe taksimetrat, deri në datën .....2011.

Bashkëlidhur, lista e detajuar e subjekteve dhe vlera e kërkuar, si dhe lista e rakorduar me degën rajonale të tatim-taksave.

Kryetari i NJQV

.....